



Ejala e Asociacionit...

Aktivitetet e përditshme të Asociacionit të Komunave të Kosovës, me vizion të qartë drejtë mbështetjes së gjithanshme për pushtetin lokal në Kosovë, i prekën në masë ngjarjet e marsit. Në këtë kontekst, me iniciativën e AKK-së, shumë kryetarë të komunave ngriten aktivitetet e tyre në shkallë të lartë për të bërë gjithë çka ishte e mundur për të ndaluar trazirat.

Rol të veçantë në vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga trazirat e 17 e 18 marsit dhe edhe AKK-ja që ishte edhe pjesë përbërëse e Komisionit Qendror Qeveritar. Padyshim puna e palodhshme e Kuvendeve Komunale në vlerësimin e dëmeve dhe përkrahje të pamohueshme për institucionet qendrore.

Përkundër apstenimit në dy takime të rëndësishme ndërkombëtare, po për shkak të ngjarjeve të marsit, AKK-ja vazhdoi punën në bashkëpunimin dhe marrjen e përvojave të ndryshme të qeverisjes lokale siç ishte edhe vizita e LGIB-së në Kosovë, pjesëmarrja në Rrjetin e Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) në Itali ku AKK-ja u bë anëtare e përhershme. Si edhe takimi me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë.

Poashtu fillimi i prezentimit të agjendave zhvillimore të 12 komunave shënoi edhe një bashkëpunim të aktiviteteve me MEF-in dhe donatorët e respektueshëm në Kosovë.

Në anën tjetër, aktivitetet si ajo e programit "Partneriteti Ndërkomunal" dhe pjesëmarrja në grupet analizuuese të IFES-it përcaktojnë mjaft fuqishëm orientimin e AKK-së dhe të Komunave të Kosovës drejt një ecje në drejtim të standardeve evropiane në shërbimet e qeverive lokale.

Sazan Ibrahim
Drejtor i Ekzekutiv i
përcaktuar i AKK-së

BULETINI INFORMATIV

i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)

Viti I, numër 3

Mars & Prill 2004

Gjatë vlerësimit të dëmeve, Asociacioni i Komunave të Kosovës dha kontribut të çmuar

Në kuadër të Komisionit për vlerësimin e dëmeve të trazirave të 17 e 18 marsit, AKK-ja ishte anëtare e Komisionit qendror Qeveritar së bashku me përfaqësuesin e Zyrës së kryeministrit dhe Grupin Qeveritar (Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria për Kulturë Rini dhe Sport dhe ajo për Ambient dhe Planifikim Hapësinor) të udhëhequr nga ministri z. Behxhet Brajšhori. Gjatë punës është debatuar për vlerësimin e dëmeve në objektet e banimit, të kulturës dhe atyre fetare të dëmtuara gjatë trazirave të 17 e 18 marsit.

Gjatë këtyre vlerësimeve, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ishte pikë kontakti për mbledhjen e shënimeve të dëmeve të shkaktuara gjatë trazirave të fundit nga Kuvendet Komunale, pëmes Drejtorateve për Urbanizmi dhe Grupeve punuese komunale. Këto shënime janë bërë publike me 16 prill nga ana e ministrit Brajšhori për dëmet në 17 komuna të Kosovës derisa për dëmet e shkaktuara në objektet e kulteve fetare, vlerësimi ka mbetur të bëhet nga grupi tjetër i punës ku do të marrin pjesë edhe ekspertët e UNESKO-së.

LETRA E DR.HERWIG VAN STAA KRYETAR I KONGRESIT TË PUSHTETIT LOKAL E REGJIONAL TË KËSHILLIT TË EVROPËS DËRGUAR Z. LUTFI HAZIRI, KRYETAR I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS, PAS TRAZIRAVE TË MARSIT NË KOSOVË

Kongresi i Pushtetit Lokal e Regjional të Këshillit të Evropës përcolli me shqetësim të madh ngjarjet e marsit në Kosovë. Kongresi dënon ashpër përdorimin e dhunës dhe i fton të gjithë liderët e Kosovës që të apelojnë për një zgjedhje të qetë të politikës aktuale dhe problemeve shoqërore.

Ishte e mirëseardhur Komunikata për shtyp e lëshuar nga Asociacionit i Komunave të Kosovës që i bëri thirrje të gjithë kryetarëve të Komunave të Kosovës që të apelojnë për përmbajtje, respekt ndaj institucioneve dhe kthim të rendit. Po ashtu, e mirëseardhur ishte edhe letra që më është adresuar nga z.Lutfi Haziri, Kryetar i AKK-së më 21 Mars 2004. Ne jemi duke llogaritur në mbështetjen e juaj të plotë për kthimin e të drejtave qytetare ndaj Serbeve dhe të sigurohet se qetësia dhe rendi janë kthyer dhe se qytetarët mund të jetojnë në kushte adekuate të sigurisë – thuhet ndër të tjera në letrën Dr. Herwig Van Staa.

Rekomandimet e Grupit Analizues për Rini dhe Barazi Gjinore për Komunitat e Kosovës

Grupi Analizues për Rini dhe Barazi Gjinore pranë IFES Ltd dhe në mbështetje të AKK-së, nxori në pah problemet dhe vështësitë me të cilat ballafaqohen zyrtarët për çështje gjinore dhe zyrtarët nga drejtoratet për rini. Pas një diskutimi intensiv, Grupi analizues për Rini dhe Barazi Gjinore arriti në mendimin e përbashkët për çështjet më urgjente të rëndësishme me të cilat përballen komunitat dhe bëri rekomandimet e mëposhtme: a) Komunitat duhet të ofrojnë mundësi të barabarta punësimi për gatë dhe për të rinjtë, b) Zërat buxhetor komunal duhet të caktohen në mënyrë specifike për veprimtaritë rinore dhe të çështjeve gjinore, c) Numri i bursave duhet të rritet për të përmbushur më mirë kërkesat për shkollim të qytetarëve të rinj, d) Nevojitet që të bashkërendohen përpjekjet me palët tjera të interesuara, siç janë organet e qeverisë qendrore, ato ndërkombëtare si edhe donatorëve privat, e) Komunave u rekomandohet fuqishëm që të promovojnë ndërgjegjësimin në mesin e stafit komunal si edhe në mesin e popullatës lidhur me Ligjin mbi barazinë gjinore, f) Zyra e Kosovës për çështje gjinore do të mund të ofronte trajnime për Komunitat.

Në vijim të kësaj çdo Komunë do të mund të mbante një debat publik mbi ligjin e ri ndërsa deputetja znj.Melihate Termkollji, kryesuese e Komisionit për Barazi Gjinore në Kuvendin e Kosovës u prezantoi pjesmarrësve të Grupit analizues, ligjin e sapo aprovuar për barazinë gjinore nga organi legjislativ i Kosovës.

Për shkak të trazirave të marsit, AKK-ja nuk mori pjesë në dy aktivitetet ndërkombëtare

Për shkak të situatës së krijuar në Kosovë me 17 e 18 mars në Kosovë, Asociacioni i Komunave të Kosovës nuk ka mundur të marrë pjesë dhe të prezentoj pushtetin lokal të Kosovës në Kongresin e pushtetit lokal të Këshillit të Evropës që u mbajt më 22 deri më 24 mars në Strasburg. Poashtu, për këtë shkak, nuk mori pjesë edhe në takimin e Rrjetit të Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) që u mbajt në Budvë me 5 dhe 7 prill.



Një delegacion i LGIB-së nga Londra qëndroi në Asociacionin e Komunave

Gjatë javës së parë të marsit në Kosovë ka qëndruar një delegacion i Zyrës Ndërkombëtare të Qeverive Lokale – (Local Government International Bureau-LGIB).

Gjatë takimeve e konsultimeve disa ditëshe, ata kanë bartur përvojat e tyre të organizimit dhe punëve të përditshme të Qeverive Lokale perëndimore. Poashtu përfaqësuesit e LGIB-së janë njoftuar me punën e Asociacionit të Komunave të Kosovës gjatë takimit me kryetarin e AKK-së z.Lutfi Haziri. Delegacioni i LGIB-së ka vizituar edhe komunën e Skënderajit dhe Obiliqit si dhe janë takuar me udhëheqjen e Prishtinës.

Në kuadër të kësaj vizite, ata kanë trajnuar edhe stafin për komunikim në Asociacionin e Komunave të Kosovës duke bartur përvojat e organizimit të qeverive lokale në Evropë në fushën e komunikimit.

Vazhdimi i dhunës është kundër të ardhmes dhe interesave të banorëve të Kosovës

Asociacioni i Komunave të Kosovës duke folur në emër të të gjitha komunave anëtare, ka apeluar tek të gjithë qytetarët që të ndalojnë dhunën kundër personave dhe pronës së Kosovës, kundër policisë, KFOR-it, Kombeve të Bashkuara dhe autoriteteve tjera ndërkombëtare. AKK-ja ndan pikëllimin dhe ngushëllon familjet kosovare që kanë pësuar humbje, dhe atyre që vuajnë nga plagët dhe humbjet e më të dashurve të tyre gjatë ngjarjeve të 17 e 18 marsit.

Kryetarët e Komunave janë takuar urgjentisht edhe aktivisht me liderët e institucioneve lokale, me policinë dhe forcat e sigurimit dhe me qytetarët që të apelojnë për përmbajtje, respekt ndaj institucioneve tona dhe kthim të rendit.

Çdo vazhdim i dhunës është kundër interesave të banorëve të Kosovës dhe kundër të ardhmes së qyteteve, fshatrave dhe trashëgimisë kulturore.

Kryetarët e komunave gjatë kësaj kohe ishin në kontakte të rregullta me institucionet qendrore të Kosovës në mënyrë që të vihej rendi dhe qetësia.

THEKSE NGA INTERVISTA E UDHËHEQËSIT TË IFES Ltd. z.ALAN PACKER DHËNË GAZETËS SË PËRDITSHME "PAVARËSIA"

A.Packer: Nëse kryetarët e komunave do të vazhdojnë ta mbështesin AKK-në, atëherë Asociacioni mund të arrijë ndryshime të dukshme

"Vështirësia në lidhje me pronën komunale qëndron në faktin se vendimet nga niveli qëndror merren pa konsideruar nevojat e plota të shoqërisë" – ka theksuar z.Alan Packer në një intervistë dhënë gazetës "Pavarësia". Në pyetjen se 'a u është bërë e padrejtë me menaxhimin e pronës komunale nga ana Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit' z.Packer ka shtuar se "sipas sistemit të mëparshëm përdorimi i tokës përcaktohej parimisht nga niveli komunal dhe autoriteti vendës, lejonte përdorimin e saj për nevoja publike dhe për ndërmarrjet. Sistemi aktual në kuadër të AKM-së punon me tokën e akorduar për ndërmarrjet përpara vitit 1999 pa marrë parasysh se nevojat e qyteteve dhe fshatrave kanë ndryshuar".

"Asociacioni i Komunave ka kërkuar që toka komunale e dhënë për përdorim të ndërmarrjeve, por që në fakt nuk është përdorur, t'i kthehet komunave në mënyrë që ato të përmbushin nevojat e tyre sociale" -tha ai. Duke folur rreth përfshirjes së IFES Ltd. në ligjin për vetëqeverisjen vendës, z. Alan Packer shtoi "deri më tani ne kemi mbështetur Asociacionin që të zërë vendin e vet në grupin e punës të caktuar nga Ministria e Shërbimeve Publike. Në këtë fazë, Ministria thjesht po punon për një draft publik. Kur drafti të ketë arritur fazën e ligjit, mendojmë se IFES Ltd, mund të japë komente konstruktive". "Ndjehem optimist për Asociacionin i cili është ende mjaft i ndjeshëm, por nëse kryetarët e komunave do të vazhdojnë ta mbështesin atë, atëherë ajo mund të arrijë ndryshime të dukshme në dobi të qytetarëve, komunave dhe nivelit qëndror" – ka përfunduar intervistën z.Alan Packer, për gazetën "Pavarësia".

AKK-ja - anëtar i përhershëm i Rrjetit të Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore

Në fillim të marsit, Rrjeti i Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) në Itali ka mbajtur një takim me Asociacionet dhe Autoritetet Lokale të Evropës Juglindore. Në këtë takim, temë diskutimi ka qenë finalizimi i statutit të këtij rrjeti. Sipas statutit të aprovuar në këtë takim, AKK-ja është bërë anëtar i përhershëm i këtij rrjeti. Rrjeti i Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore është trup i Këshillit të Evropës.

Nga takimi i Grupit Analizues për Planifikim Urban dhe Rural

Në punën e Grupit Analizues për Planifikim Urban dhe Rural u shqyrtuan çështje të aspekteve të ndërlidhura me nivelin lokal. Gjatë takimeve, një rëndësi e veçantë i është kushtuar përgatitjes së Planit hapësinor të Kosovës dhe strategjive zhvillimore komunale. Brengat kryesore të të gjithë pjesëmarrësit ishin, afati 18 mujor i paraparë për përgatitjen e këtij plani, që është thënë të jetë i shkurtër, si dhe mungesa e pajisjeve elementare për punë profesionale në departamentet që do të merren me këtë punë. Në të ardhmen, një ndër qëllimet apo përpjekjet nëpër komuna do të jetë edhe stimulimi i personave profesional që të punojnë në komuna.

Vizitë e sukseshme e dhjetë kryetarëve të komunave të Kosovës në ShBA

Kryetari i komunës së Prishtinës, Podujevës, Fushë-Kosovës, Kaçanikut, Therandës, Drenasit, Vitisë, Rahovecit, Leposaviqit dhe Shtërpçës qëndruan në ShBA nga 22 shkurti deri më 17 mars.

Qëllimi i kësaj vizite në ShBA kishte të bëjë me përkrahjen e zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Organizator i këtij programi trejavor ishte Universiteti Georgetown – Qendra për Zhvillim dhe Arsim Ndërkulturor dhe sponsorizuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan, përkatësisht Byroja e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore e Zyrës së programeve të shkëmbimit të përvojave.

Javën e parë, kryetarët kanë vizituar Washington DC për të mësuar historinë e Amerikës, si Shtëpinë e Bardhë dhe shumë monumentet kulturore. Në fillim ata kanë marrë pjesë në një seminar i cili kishte për temë zgjidhjen e konflikteve si dhe në Konferencën amerikane të kryetarëve. Poashtu kryetarët kanë ndjekur programin zyrtar në seminarin në “Georgetown University” ku janë diskutuar temat e udhëheqjes

zhvillimit e bashkëpunimit dhe ndryshimit personal e të organizuar si dhe në zgjedhjen e problemeve në mënyrë kreative. Në javën e fundit në Washington ata kanë marrë pjesë në programin e trajnimit që përfshinte tema interesante, takime me autoritete lokale e qendrore të ShBA-ve dhe diskutime përvojash në avancimin e qeverisjes lokale si dhe kanë përcjellur seminarin me temën “Inicjalizimi dhe implementimi i ndryshimit” të drejtuar nga z.Ted Rosen.

Kryetarët e komunave të Kosovës janë takuar me kancelarin e Ajovës dr.John T. Blong dhe senatorë e kongresistë të Ajovës, pastaj me kryetarin e Bashkisë së Illionisit z.Mark Shwiebert, kryetarin e qytetit rural Hdridge z.Frank Wood, me drejtorin e financave të qytetit Davenport z.Kent Kolwey.

Ata janë njoftuar për përmbledhjet e zhvillimit ekonomik të komuniteteve nga drejtori ekzekutiv për zhvillim z.Mark Kapfer dhe drejtoresha e Qendrës për zhvillimin e bizneseve të vogla znj. Ann Hutchinson.

Gjatë kësaj vizite, në kuadër të projektit “Kosovo Mayors Exchange” kryetarët janë pajisur edhe me diploma për pjesëmarrjen e tyre në seminare.



Dhjetë kryetarë e komunave të Kosovës gjatë vizitës në SHBA

Këshilli i Evropës premtan përkrahjen për Komunitat e Kosovës

Shefi i zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Owen Master dhe z.Lutfi Haziri – kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, kanë biseduar rreth funksionimit të pushtetit lokal, reformave në administratën lokale në Kosovë si dhe bashkëpunimin ndërkufitar në rajon, projekt ky që ka përkrahjen edhe të Këshillit të Evropës.

Z.Master ka premtuar përkrahjen e Këshillit të Evropës për proceset pozitive nëpër komunitat e Kosovës dhe në veçanti në sferat e arsimit dhe të kulturës, si dy segmente mjaft të rëndësishme shoqërore.

Ndërkaq, Lutfi Haziri, duke çmuar përkrahjen e Këshillit të Evropës, ka thënë se bashkëpunimi ndërkufitar në rajon duhet të zhvillohet më tutje dhe për këtë ekziston interesimi edhe nga palët tjera.

Kurse gjatë takimit me z.Sazan Ibrahim, drejtori ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së, z.Owen Master është njoftuar me punën dhe aktivitetet e AKK-së si dhe planet e objektivat për të ardhmen.

AKK-ja ndërmjetësoi takimin mes përfaqësuesëve të BE-së dhe inspektorëve sanitarë

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka ndërmjetësuar takimin mes përfaqësuesëve të BE-së me zyrtarët e Inspeksioneve Sanitare të Ushqimit të komunës së Prishtinës, Gjilanit, Prizrenit, Pejës, Mitrovicës, Ferizajit dhe të Gjakovës për implementimin e projektit për sistemin e sigurtë të ushqimit në Kosovë.

BE-ja ka financuar këtë projekt për ndërtimin e kapaciteteve njerëzore, trajnimin e inspektorëve si dhe paisjen e komunave me pajisje laboratorike dhe pajisje për punën e inspektorëve.

Në këtë takim është biseduar rreth gjendjes së tanishme të kontrollit të ushqimit, kushtet e punës dhe për rrethanat në të cilat inspektorët komunal janë duke punuar.

Eksptertët e Bashkimit Evropian të kontrollit të ushqimit do të vazhdojnë kontaktet dhe bashkëpunimin me përfaqësuesit e komunave të Kosovës.

Delegacioni i AKK-së vizitoi Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë

Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) vizitoi Shqipërisë, ku pati takime të rëndësishme si me institucionet qendrore ashtu edhe ato lokale. Kjo vizitë ishte e sponsorizuar nga Fondacioni SOROS. Gjatë kësaj vizite, delegacioni i AKK-së është takuar me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, ku u bisedua për ngritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave si dhe me Ministrin e Pushtetit Lokal z.Ben Blushi. Gjatë takimit me z.Blushi, kryetari z.Lutfi Haziri e njoftoi atë me përgatitjet që janë duke u bërë në Kosovë për përpilimin e draftligjit për pushtetin lokal e në veçanti për procesin e reformave, ku ministri ofroi ndihmë me ekspertë nga Shqipëria. Delegacioni, që e udhëhiqte kryetari i AKK-së z.Lutfi Haziri, përbëhej nga z.Ramadan Gashi, z.Fehmi Mujota, z.Skender Zogaj, z.Agim Veliu dhe znj.Merita Krasniqi, ku përveç takimeve tjera ka vizituar edhe qytetin e lashtë të Durrësit.

BULETINI INFORMATIV

Boton: ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Viti I, Nr. 3 - Mars & Prill 2004

Adresa:

Rr.Isa Kastrati, Nr.113

Tel: 038/ 245 731

Fax: 038/ 245 732

komunat_akk@hotmail.com



Statusin e Vëzhguesit

AKK-ja nisi programin “Partneriteti Ndërkomunal”

AKK-ja ka filluar punën në programin “Partneriteti Ndërkomunal” i cili do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me URID-it (Grupi për Zhvillim të Infrastrukturës Rurale dhe Urbane) ku është planifikuar që t’u ndihmohet komunave drejt zhvillimit të infrastrukturës ndërkomunale për të kthyerit si dhe integrimin e tyre.

Aktualisht, komunat e Kosovës janë duke bërë identifikimin e projekteve të cilat mund të kenë edhe përkrahjen financiare (minimumi 15 % të vlerës së projektit) dhe kështu AKK-ja së bashku me URID-in do të asistojë në vlerësimin, dizajnimin dhe implementimin e projekteve si dhe identifikimin e donatorëve. Ky projekt, njëkohësisht, do të përforcojë bashkëpunimin ndërkomunal dhe rajonal që do të kishte një qëllim rreth qarkullimit të lirë të njerëzve dhe zhvillimit ekonomik në rajon.

I emërtuar si „Partneritet Ndërkomunal” në secilin projekt duhen të përfshihen së paku dy komuna dhe synimi është që ato projekte të jenë në zhvillimin apo përmirësimin e kushteve të komuniteteve.

Me këtë do të bëhet edhe një lehtësim për komunat të cilat kanë buxhet të vogël dhe janë të përqendruara në projektet brenda komunave.

Projektet e propozuara mund të jenë të ndryshme nga lëmia e infrastrukturës së përgjithshme si ato elektrike (largëpërçues, furnizimi për shtëpi, ndriçimi etj.), ujësjellës dhe kanalizim, pastaj, në transport (rrugë, ura etj), ndërtesa publike (shkolla, qendra edukative, çerdhe, qendra kulturore etj.), objekte shëndetësore (klinika, spitale) etj.

Ndërsa këto projekte duhet të përfshijnë në vete edhe disa kritere si a) të rezultohet me riaktivizim të shpejtë të infrastrukturës dhe/ose shërbimeve ekzistuese ndërkomunale; b) Të sigurohen shërbime esenciale për banorët e lokacionit të projektit, sidomos për refugjatët që janë kthyer në shtëpitë e tyre apo banorët rezident; c) të promovohet, në mënyrë direkte ose indirekte, ringjallja e ekonomisë lokale dhe të sigurohen benefite të rëndësishme ekonomike, sidomos punësimi brenda komunës; d) të jetë e sigurtë se benefitet e projekteve janë të hapura dhe në dispozicion për të gjitha grupet etnike; e) të mirren në konsiderim nevojat e të paafteve dhe të të hendikepuarëve; f) të sigurohet se shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes sigurojnë qëndrueshmëri; dhe g) të përfshihen të gjitha përmirësimet e arsyeshme të ndikimeve potenciale negative të ambientit.

Pas grumbullimit të të dhënave, në fund të muajit prill pritet të filloj realizimi konkret i këtij programi të rëndësishëm të AKK-së.

Agjendat e tyre zhvillimore i kanë paraqitur komunat e rajonit të Prizrenit

Nën organizimin e Ministrisë së Ekonomisë e Financave (MEF) dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) dhe në implementim të UNOPS-it, pesë komuna të Kosovës kanë paraqitur agjendat e tyre komunale zhvillimore, para të pranishmëve të shumtë në lokalet e Qeverisë së Kosovës e ku merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e UNOPS-it, UNDP-së, US-OFFICE, UNMIK-ut, UN HABITAT, IOM etj.

Sefedin Sefaj sekretar i përhershëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në hapje të kësaj konference ka theksuar se “MEF-i ka propozuar që AKK-ja të kenë qasje më të madhe në përgatitjen e planeve zhvillimore të komunave”. Z.Sefaj ka falenderuar përfaqësuesit e UNDP-së që kanë dhënë përkrahje të madhe për këto iniciativa dhe për “besimin që kishte në ne” siç u shpreh ai. MEF-i, ka vazhduar sekretar i përhershëm i saj z.Sefedin Sefaj, mirëpret agjendat zhvillimore të komunave duke shqyrtuar edhe mundësitë e financimeve të ndryshme së bashku me donatorët e jashtëm.

Drejtori i përcaktuar ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim, duke përshëndetur të pranishmit, tha se qëllimi kryesor i paraqitjes së këtyre agjendave “është planifikimi në nivelin komunal me gjithëpërfshirje të aktorëve kyç lokal”. Ndër qëllimet tjera z.Ibrahimi ceku “edhe koordinimin në vijën vertikale në mes të komunës dhe MEF-it në drejtim të planifikimit të buxhetit komunal, për një planifikim të mbështetur në nevojat e popullsi së së komuniteteve”. Drejtori i AKK-së në këtë paraqitje shtoi se “këtu janë ftuar donatorët, me qëllim, mobilizimi shtesë të mjeteve financiare për projekte të rëndësishme komunale dhe regionale”.

Në takimin e parë agjendat e tyre zhvillimore i kanë paraqitur përfaqësuesit e pesë komunave të rajonit të Prizrenit, si komuna e Suharekës, Malishevës, Rahovecit, Dragashit dhe të Prizrenit. Ndërsa në pjesën e ardhshme, programet e tyre zhvillimore do t’i paraqesin komunat e rajonit të Gjilanit duke përmbytur kështu numrin prej 12 komunave sa janë të implikuara në këtë projekt.